



Short Bio

Name:	Ganimete Morina - Kryetare e Asociacionit të Para Tenisit me Karroca në Kosovë
Organization:	Asociacioni i Para Tenisit me Karroca në Kosovë
Email:	gana_b_2@hotmail.com

Bio:

Ganimet Morina është ekonomiste, e diplomuar në nivelin master i Arteve në Administrim Biznesi në Fakultetin Ekonomik të Universitetit Publik në Prizren “Ukshin Hoti”. Aktualisht ajo është sekretare në shkollën fillore të mësme të ulët “Dituria” në Samadrexhë, komuna Suharekë, ku misioni i saj në pozitën e sekretares është funksionimi i qetë, efikas dhe i organizuar i shkollës duke ofruar mbështetje të pandërprerë administrative për të gjithë komunitetin ku punon. Ajo gjithashtu mbanë pozitën e Kryetares në Asociacionin e Para Tenisit me Karroca në Kosovë ku synimi i saj është promovimi, zhvillimi, mbështetja dhe gjithëpërfshirja e personave me nevoja të veçanta në para sportin e tenisit me karroca në Kosovë. Ajo është dhe Anëtare e Bordit Ekzekutiv në Komitetin Paralimpik të Kosovës që nga viti 2022, e cila shërben në vendimarrje strategjike, promovimin e sportit paralimpik dhe zhvillim të bashkëpunimeve në KPK. Para dy vite kryetarja e APTKK-ës mbantë pozitën e Anëtares së Bordit Ekzekutiv në Federatën e Tenisit në Kosovë.

Ganimetja ka qenë e angazhuar dhe kampione bashkë me parasportistët e saj në sportin e tenisit me karroca në lojrat parasportive në Vushtrri në vitin 2022 që me krijimin e Asociacionit të Para Tenisit me Karroca në Kosovë. Kryetarja e APTKK-ës në korrik të 2022, ishte mirëpritur dhe nderuar me mirënjohje bashkë me parasportisten e saj, nga kryetari i komunës së Suharekës. Ganimetja ka qenë dhe moderatore në lojrat parasportive dhe në aktivitete tjera e caktuar nga Komiteti Paralimpik i Kosovës. Ajo është nderuar me titullin “Hynjesha e Shtetit” për kontribut dhe respekt ndaj të drejtave të kategorive të marginalizuara në Kosovë, trofe i ndarë nga Ambasadorja e Vullnetit të Mirë për Kosovën, nominuar nga Komiteti Paralimpik i Kosovës. E çertifikuar në disa organizata për persona me nevoja të veçanta në disa sfera si dhe në pjesën ekonomike të profilit të saj.

Moto: **Fuqizoj veten, frymëzoj të tjerët, ndërtoj mundësi!**